
Lën Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga

Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018

Objekti: Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rruga "M. Xhemali", rruga "Hajdar Tafa", rruga "Qemal Butka" dhe rruga "Frang Bardhi", Tiranë (plus shtesë kontrate)

Investitori: Bashkia Tiranë

Vlera e Investimit: 108,394,248 lekë + shtesë kontrate, 21,480,666 lekë

Periudha kohore: Qershor 2016, deri në nëntor 2017

Inspektimi është kryer: Shkurt 2019

Ky objekt është zbatuar jashtë zonës së Unazës së Madhe të qytetit të Tiranës, në një bllok banimi pranë zonës së Selitës, pjesë e Bashkisë Tiranë. Blloku i banimit ku është investuar kufizohet midis rrugëve "Mentor Xhemali", rrugës "Hajdar Tafa", rrugës "Qemal Butka" dhe rrugës "Frang Bardhi", me një sipërfaqe të përgjithshme të këtij blloku banimi rreth 70,000 m² (sipërfaqja e shënuar përfshin ndërtesat, rrugët, sheshet, trotualet, muret rrethuese, oborret e shtëpive dhe vilave, sipërfaqet e gjelbëruara, etj.). Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së bllokut të banimit në momentin e investimit ka qenë e amortizuar. Është një zonë banimi e kombinuar me ndërtime të kryera para viteve 1990, si edhe ndërtime të reja, të bëra gjatë viteve të fundit.

Projekti ka ndërhyrë në rikualifikimin urban të pjesshëm të këtij blloku banimi, duke përfshirë rikonstruksionin e shtresave rrugore të rrugëve kryesore midis ndërtesave (shtrimi me "binder" dhe shtrimin me asfalt të tyre), në rehabilitimin e plotë të shtresave të dëmtuara të trupit të rrugëve të brendshme, me të gjitha komponentët e saj (stabilizanti plus nënshtresat e tjera), në rehabilitimin e rrjetit të ujërave të bardha dhe të zeza, në rikonstruksionin e tubacionit të ujit të pijshëm, me rikonstruksionin e të gjitha pusetave të ujërave të bardha e të zeza, në sistemimin e plotë të trotuareve, bordurave anësore të rrugëve, në rehabilitimin e rrjetit të ndriçimit, në sinjalistikën rrugore, në rehabilitimin e fasadave të mureve rrethuese të shtëpive të banimit (veshje e tyre me pllaka guri dekorativ, sipas një modeli standard të miratuar paraprakisht), rikonstruksioni i kangjellave të shtëpive që kufizohen nga rruga kryesore, etj.

Projekti i zbatimit ka parashikuar një rehabilitim të pjesshëm të këtij blloku banimi. Është një zonë banimi, kryesisht me shtëpi banimi me oborre rrethuese dy dhe tre katëshe, si edhe me pallate banimi 4 dhe 5 katëshe. Me infrastrukturë të rregulluar që nga koha e ndërtimit të tyre, por që në momentin e investimit ka qenë e nevojshme ndërhyrja për rehabilitimin e saj, kjo edhe për shkak të amortizimit të saj. Punimet kanë filluar rreth muajit qershor të vitit 2016 dhe kanë përfunduar në muajin nëntor 2017, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Për shkak të punimeve të paparashikuara në këtë objekt, investitori (Bashkia Tiranë) ka shfrytëzuar plotësisht bazën ligjore, për të dhene shtesë kontrate për objektin, me një vlerë që zë rreth 19.8 % të vlerës së kontratës fillestare, po aq sa është edhe baza ligjore për shtesën e punimeve të paparashikuara (20% e vlerës së kontratës bazë).

Afati i garancisë së punimeve për objektin nuk ka përfunduar ende (afati i garancisë së punimeve për këtë objekt, duhet detyrimisht të jetë deri në dy vjet). Nisur nga sa më sipër, investitori do duhet të kontrollojë menjëherë investimin në të gjithë komponentët e tij. Gjithashtu duhet të përmendim se zbatimi i punimeve për këtë bllok banimi është bërë në kushte optimale, pasi rrugët gjatë periudhës së rikonstruksionit kanë qenë pothuajse të bllokuara. Edhe pse objekti ka vetëm 15 muaj që është përfunduar, cilësia e zërave kryesor të punimeve është në kushte poshtë nivelit mesatar. Theksojmë këtu se është bllok banimi vetëm me trafik të brendshëm, për banorët e tij.

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- ✓ Trupi i rruges ka lëvizje të vogla (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit (në vendet ku janë hapur gropa dhe shtresat e asfaltit janë më të dukshme, trashësia e shtresave të asfaltit është shumë e vogël);
- ✓ Në disa segmente ka sipërfaqe të shtresave të asfaltit, të cilat kanë filluar që të thërrmohen (gjë që tregon se shtresa e asfaltit të hedhur, nuk është material cilësor dhe sipas standardeve);
- ✓ Vihen re ulje dhe lëvizje të pllakave të trotuareve;
- ✓ Trotualet anësore të rrugës janë variabël (diku është 1.1 m. diku 0.4 m, diku vetëm bordura anësore e rrugës, e diku nuk ekzistojnë fare);



Fig. 1
Shtrim i shtresave asfaltike ne menyre jo te njetrajtshme

- ✓ Nuk janë respektuar sipas standardit të kërkuar, lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (ato pothuajse mungojnë fare);
- ✓ Ka puseta të dëmtuara dhe të vendosura jo në nivel të njëtrajtshëm me trupin e rrugës (me “parete” anësore të tyre të dëmtuara);



Fig. 2
Dëmtim i shtresave asfaltike

✓ Shtresa e betonit në kunetat anësore në disa segmente rrugore, kanë dëmtime dhe plasaritje të dukshme. Nuk është hequr ende materiali prej druri, të cilat janë përdorur nga firma zbatuese për lënien e “fugave” për kunetat anësore të rrugës. Në disa segmente rrugore kunetat anësore prej betoni mungojnë plotësisht.

Vihen re grumbullime të materialeve inerte (rërë+zhavorr), në të gjitha pusetat e ujërave të shiut. Pastrimi i tyre nga punonjësit e mirëmbajtjes së bashkisë nuk bëhet rregullisht, duke sjellë përmytje dhe dalje të ujërave të bardha, gjatë reshjeve të shiut (me shenja të dukshme dhe e evidentuar edhe nga banorët e zonës).

Fig. 3
Kuneta te demtuara



Defektet e shfaqura në shtresat asfaltike të rrugës, trotuaret anësore të saj, thyerja e kapakëve të pusetave, heqja e lëndës së drurit dhe plotësimi me fuga i të gjithë shtresave prej betoni të kunetave, do duhet detyrimisht t’i bëhen prezente firmës zbatuese të punimeve nga specialistët përgjegjës pranë Bashkisë Tiranë. Firma zbatuese e punimeve do duhet në mënyrë të menjëherëshme të ndërhyjë me fondet e veta, për riparimin e menjëhershëm të defekteve të evidentuara, pa pritur degradimin e mëtejshëm të saj apo përfundimin e garancisë së punimeve të objektit (fondi i garancisë së objektit është 5 % e vlerës së situacionit përfundimtar). Vetëm pas riparimit të defekteve të shfaqura, Bashkia Tiranë duhet të bëjë ç’bllokimin e garancisë së punimeve për këtë vepër.



Fig. 4
Trotuare dhe shtresa asfaltike jo te
njetrajtshme

Konkluzione në lidhje me objektin:

- *Do duhet të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit të trupit të rrugëve dhe aty ku dukshëm asfalti rezulton i "gripuar" (dëmtuar) të rishtrohet e gjithë shtresa e asfaltit;*
- *Të bëhet riparimi i pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera në to;*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuara në trotuare, për lidhje të njëtrajtshme të tyre me trupin e rrugës dhe pa pengesa;*
- *Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pushtave të ujërave të bardha dhe të zeza (zvendësimi i kapakëve të dëmtuar dhe betonit të thërrmuar përreth tyre);*
- *Të shikohen rigorozisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, baza ligjore dhe argumentet e dhëna nga projektuesi, supervizori dhe firma zbatuese e punimeve, për shtesën e kontratës së punimeve, e cila është sa vlera maksimale e lejuar nga ligji për prokurimet publike (20% e vlerës së kontratës bazë të lidhur);*
- *Sipas mendimit tonë, vlera për riparimin e defekteve të konstatuara, mendojmë se përbëjnë rreth 7 deri në 15 % të vlerës së situacionit përfundimtar, për të cilat do duhet të informohet menjëherë firma zbatuese e punimeve.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si edhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.01.2001, nr. 2, datë 13.05.2005 dhe nr. 1, datë 16.06.2011, "Për mbikëqyerjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

**Bashkëlidhur një foto ajrore e bllokut të banimit ku është investuar
(me vijë të kuqe është kufizuar blloku i banimit ku është kryer rikonstrukcioni)**

